



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.15/2017

Prishtinë, më 12 mars 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu, dhe Albulena Balaj Halimaj.

Munguan: Mirjeta Kalludra dhe Mytaher Haskuka.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Avni Jashari dhe Nora Azemi-AKP, Milazim Gashi, Rafet Gashi, Shukri Gashi dhe Bekim Gashi-banorë të Fshatit Atmaxhë, dhe Agnesa Haxhiu-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Diskutim lidhur me çështjen privatizimit të tokave: Të ftuar Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizim dhe deputeti Arbër Rexhaj, përfaqësues i peticionit të fshatit Atmaxhë

Duda Balje, kryetare: Në këtë mbledhje i kemi të pranishëm përfaqësuesit e AKP-së, z.Avni Jashari dhe znj. Nora Azemi si dhe deputetin Arbër Rexhaj, përfaqësues i peticionit të fshatit Atmaxhë dhe banorët e saj, për të diskutuar në lidhje me privatizimin e tokave në këtë fshat.

Komisioni ka pranuar një peticion në lidhje me privatizimin e tokave në fshatin Atmaxhë, komuna e Prizrenit dhe për tu njoftuar më shumë lidhur me këtë çështje, më pas ia dha fjalën deputetit Arbër Rexhaj.

Arbër Rexhaj: Si deputet, kam marrë përgjegjësi për të përfaqësuar nënshkruesit e këtij peticioni, ku disa përfaqësues të tyre janë sot bashkë me mua para Komisionit Funkcional. Përmes këtij peticioni banoret shprehin shqetësimin dhe indinjatën e thellë për përfshirjen e tokave bujqësore në procesin e privatizimit, ndaj këtyre tokave ne jemi sjellë si pronarë juridik dhe i kemi poseduar për një periudhë kohore prej më shumë se 60 vite.

Kërkesa e parë e këtij peticioni është ndalimi i cilësdos procedurë për privatizimin e tokave bujqësore të fshatit Atmaxhë, ndërmarrjen e të gjitha masave nga AKP-ja, për ndaljen e procesit të privatizimit për tokat në fshatin Atmaxhë dhe ofrimin e mundësisë që në procedurën e privatizimit të nënshkruar në këtë peticion, tu njihet e drejta e parablerjes në cilësinë e poseduesve me mirëbesim.

Ky peticion është nënshkruar pothuajse nga të gjithë përfaqësuesit e lagjeve të fshatit, me kërkesë të tyre kam parashtruar pyetjet te kryeministri z.Ramush Haradinaj, i cili ka thënë që me vendim të Qeverisë është pezulluar për një vit çështja e privatizimit të tokave bujqësore në gjithë territorin e Kosovës përfshirë edhe në fshatin Atmaxhë.

Banorët po i brengos që ky vendim i Qeverisë nuk po respektohet dhe po vazhdon më tutje procesi i privatizimit të tokave të tyre në këtë fshat.

Milazim Gashi, banor i fshatit Atmaxhë, tha se tash për tash bëhet fjalë për 6 hektarë e 70 ari, dhe të tjerat po i presim, prej vitit 2005, kam dokument dhe e kam listën poseduese.

Kryetarja, pyeti nëse këta 6 hektarë janë privatizuar.

Milazim Gashi, tha se janë privatizuar e kemi dokumentin se cili person i ka blerë dhe ai na thotë , ejani të bëjmë marrëveshje për të na shitur neve banorëve.

Ne iu kemi drejtuar institucioneve kompetente për të bërë anulimin e këtij privatizimi dhe mos të vijë deri te ndonjë problem më i madh.

Avni Jashari, tha se AKP-ja vepron sipas Ligjit për themelimin e AKP-së, që e ka hartuar Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i agjencisë është i përcaktuar me nenin 2 paragrafi 2.2, që në mënyrë decidive theksohet se Agjencia shet, transferon dhe likuidon ndërmarrjet shoqërore dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9, të ligjit të AKP-së, pa vonesa të panevojshme, preambula i referohet edhe zhvillimit ekonomik dhe interesit publik që Agjencia të bëjë transformimin e pronës shoqërore në pronë private.

Për rastin e banorëve të fshatit Atmaxhë, që kane bërë kërkesë të mos privatizohen tokat e caktuara, Agjencia i ka trajtuar me seriozitet dhe sipas ligjit.

Qytetarëve të fshatit Atmaxhë, të cilët kanë bërë këtë kërkesë dhe deputetit Arbër Rexhaj, ju kemi dorëzuar me 22 nëntor të vitit 2017, një përgjigjeje në pyetjen e cila na është dërguar në Agjenci, në të cilën ju kemi përgjigjur në kërkesën e tretë të peticionit që ka të bëjë me kërkesën për parablerje.

Ligji i lejon vetëm dy raste kur blerësit kanë të drejtë në kërkesën për parablerje, është neni 44 paragrafi 2 i Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, kur e drejta e parablerjes mundë të konstituohet me ligj ose me kontratë, në rastin aktual asnjërin rast nuk e kemi.

Me ligjin e AKP-së nuk është e përcaktuar se e drejta e parablerjes ti jepet fshatarëve të një lokacioni, po ashtu, në asnjë dokument të brendshëm të agjencisë nuk kemi ndonjë rast që më parë prej se ka filluar procesi i privatizimit në vitin 2002, që i është njohur e drejta e parablerjes ndonjë pale për shitjen e tokës në bazë të një kërkesë së tyre pa pasur përpara një

marrëdhënie të komercializimit apo të qiramarrjes.

Sa i përket kërkesës për ndalimin e cilësdo procedurë të privatizimit të tokave bujqësore, momentalisht ne nuk e kemi bordin e drejtorëve funksional, kemi vetëm kryetarin dhe zëvendëskryetarin e bordit të drejtorëve, e edhe ashtu shitjet nuk janë duke ndodhur prej dhjetorit të vitit 2017.

Pritet që Kuvendi ti emërojë anëtarët e bordit edhe pas emërimit të anëtarëve të bordit, bordi i drejtorëve do ti shqyrtojë edhe planet e agjencisë lidhur me valët e ardhshme të shitjes që ka qenë edhe vala 39. Tash për tash nuk jemi duke realizuar shitje.

Sa i përket kërkesës së dytë të peticionit për ndërmarrjen e masave nga agjencia për ndaljen e procesit të privatizimit të tokave në fshatin Atmaxhë, përderisa nuk ka një vendim të Kuvendit të Kosovës, e nuk mund të dalim jashtë ligjit të AKP-së, prandaj ne i nënshtrohemi vendimeve të Kuvendit dhe Ligjit të cilin e ka aprovuar Kuvendi dhe nuk mundemi në mënyrë të njëanshme të bëjmë ndaljen e procesit të privatizimit.

Duda Balje, kryetare, tha se ka një aktvendim nga Komuna e Prizrenit, të cilin e ka nënshkruar drejtori i kadastrës së Komunës së Prizrenit, me datën 11.1 2018. Ajo pyeti se në cilin vit është hap tenderi për privatizimin e këtyre 6 hektarëve.

Avni Jashari, theksoi se prej muajit dhjetor të vitit të kaluar nuk kemi bord të drejtorëve. Aktualisht e kemi kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Valët e privatizimit të cilat kanë qenë në vitin 2017, e të cilat janë aprovuar nga bordi i drejtorëve, normalisht që procedura ka qenë që ato palë që kanë aplikuar në tender ju kanë aprovuar shitjet, edhe kanë vazhduar kontratat e privatizimit. Sa i përket vitit të hapjes së tenderit për 6 hektarë, Jashari tha se nuk e ka atë informatë për momentin.

Ai tha se nuk qëndron fakti se kjo tokë ka qenë në emër të banorëve, sepse agjencia nuk shet toka private, këto toka kanë qenë të gjitha të regjistruara në emër të ndërmarrjes shoqërore, për momentin valët e ardhshme të privatizimit janë të pezulluara deri në emërimin e bordit të drejtorëve.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se përveç këtij peticioni ne kemi parë nëpër media që tokat bujqësore edhe pas vendimit të Qeverisë po privatizohen. Sa i përket fshatit Atmaxhë, tha se e njeh personalisht dhe se ai fshat jeton prej atyre tokave dhe nëse ato toka privatizohen e vë në diskutim jetesën e tyre. Kemi pa që Qeveria ka marrë një vendim dhe me çdo ligj që ju punoni edhe Ligji i AKP-së, bie pas vendimit të Qeverisë dhe ju nuk keni pasur të drejtë as një ari se lëre më 6 hektarë ti privatizoni pas këtij vendimi. Nuk na intereson a funksionon bordi apo jo, ne na intereson pse AKP-ja po privatizon toka edhe pas vendimit të marrë nga Qeveria.

Drita Millaku: Ajo çka është më e keqja nga ky privatizimi i këtyre tokave është se në këtë fshat ka filluar konflikti në mes banorëve dhe çka nëse në të ardhmen ky konflikt rezulton me

ndonjë vepër të rëndë, gjë që nuk duhet të lejojmë të ndodhë, por çka duhet të ndërmarrim ne për të parandaluar këtë.

Luljeta Veselaj-Gutaj: Problemi me pronat të cilat nuk kanë qenë të regjistruara në emër të pronarëve, shitblerjet të cilat janë bërë para 60 apo 70 viteve, është një fenomen që ka ndodhë në të gjithë Kosovën e jo vetëm në Atmaxhë. Jemi në një proces që duhet t'i japim mbështetje konkrete. Si anëtarë të komisionit kemi shpreh gatishmërinë për ti mbështetur banorët e Atmaxhës dhe të gjithë banorët të cilët kanë nevojë. Kemi një vendim të Qeverisë për pezullim të privatizimit të tokave bujqësore për një vit. U tha se vendimi për tokat në Atmaxhë është marrë para vendimit të Qeverisë dhe procedura ka zgjatë ndoshta deri 6 muaj, kjo ka ndodhë është marrë vendimi por çka të bëjë tash e tutje, cilat janë procedurat apo si mund ta

pezullojmë këtë vendim për privatizim të këtyre tokave që janë blerë nga personi në fjalë? Ajo po ashtu pyeti se a ka qenë i shpallur konkursi për privatizim të këtyre tokave.

Milazim Gashi, tha se nuk jemi lajmëruar nga AKP-ja, që të aplikojmë për blerje të këtyre tokave. Nuk kemi pasur dijeni se po ndodhë një proces i tillë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se do ti shikojmë ligjet dhe do të shohim se cili ligj i jep përparësi banorit që ka shfrytëzuar tokën, u tha se ligji për pronësinë nuk e thotë se ai që ka shfrytëzuar tokën me qenë favorit për blerje. Mendoj se nuk ka logjik me ardhë dikush tjetër në rend para personave që kanë punuar këtë tokë, dhe ju nuk keni dokument se e keni punuar atë tokë.

Milazim Gashi, tha se ka dokumente nga koha e paraardhësve e deri tek babai, dhe dokumenti ekziston por dihet koha e mëhershme qysh i kanë marrë pronat qysh i ka kthye dhe ne jemi duke e kryer punën se si ti rikthejmë këto toka përmes dhënies së drejtës për blerje.

Shukri Gashi, tha se disa nuk kanë dokumente përfshi edhe atë, por që e kanë punuar nga gjyshi, babai e tani personalisht ai. Ne jemi që mos të ketë konflikte mes banorëve, por nëse kjo tokë shitet, ne jemi blerësit e secilës tokë kush e ka punuar.

Mexhide Mjaku-Topalli, pyeti a ka ndonjë udhëzim administrativ që ju lejohet personave të cilët e kanë shfrytëzuar tokën që të kenë përparësi në blerje, në qoftë se AKP-ja ka marrë vendim për privatizim të tokave para vendimit të Qeverisë. Cila është data kur është marrë ai vendim, sepse kërkesa nga banorët është parashtruar më 6.11.2017, ndërsa më 10.11.2017, është marrë vendimi nga Qeveria për pezullim.

Ajo pyeti edhe lidhur me një parcelë në Podujevë, që është ndërmarrje shoqërore, ku janë të punësuar 200 gra, në një fabrikë për përpunimin e specave dhe është një problem mes komunës dhe AKP-së. A është zgjidhur ky problem?

Teuta Haxhiu, tha se shqetësimin më të madh e ka se a ka pas shpallje publike për privatizim të këtyre tokave dhe a keni pasur të drejtë juridikisht të vazhdoni pas vendimit të qeverisë, për këtë dua të kemi shkresë zyrtare nga AKP-ja.

Arbër Rexhaj, tha se ka lëndë të dërguara edhe në policinë e Prizrenit, ju e dini nëpër fshatra çfarë mentaliteti kemi, është e udhës që institucionet tona të gjejnë rrugën më të drejtë drejt

përmbushjes së kërkesave të këtyre qytetarëve, por kjo arrihet vetëm nëse ka vullnet dhe ju si komision duhet të dilni me një përfundim, se këtu ka të bëjë me shkelje të drejtave të njeriut.

Avni Jashari, tha se lidhur me anulimin e kësaj kontrate, e vetmja që mund të anulohet një kontratë të tillë është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, e jo Kuvendi i Kosovës. Kështu është me Ligjin për AKP-në dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Edhe kontrata si e tillë nuk anulohet, por nëse gjykata ia vërteton procesin, atëherë vetëm bëhet kompensimi i mjeteve. Prej momentit të aprovimit të kontratës së shitjes e deri te nënshkrimi i kontratës mund të zgjasë 4-8 muaj. Tenderi ka qenë publik, i shpallur në media dhe shpallja bëhet dy herë dhe të gjitha komunat njoftohen 30 ditë më herët. Nuk ka pas ndonjë pengesë ligjore për ndalimin e shitjes, pas procesit të tenderimit, zyrtarët përkatës që janë në agjenci i dorëzojnë rekomandimet në bordin e drejtorëve për ta aprovuar shitjen apo jo. Në këtë rast Bordi i Drejtorëve e ka aprovuar shitjen para dhjetorit të vitit 2017, dhe kontrata e nënshkruar është vetëm akt formal.

Për rastin në Podujevë, tha se ky kontest pronësor ekziston tash 6 vjet. Komuna në mënyrë të njëanshme e ka regjistruar pronën shoqërore si pronë komunale, AKP-ja në vitin 2012 dhe 2013, ka bërë kërkesë në Ministrinë e Pushtetit Lokal që ta kthejë gjendjen në kohën paraprake të regjistrimit të pronës dhe jemi në kontest gjyqësorë me komunën e Podujevës deh tash për tash nuk ka ndonjë rrezik për gratë e punësuarat në atë ndërmarrje.

Arber Rexhaj, tha se nuk u përgjigjet se a e respektoni vendimin që e ka marrë Kryeministri.

Avni Jashari, theksoi se pyetjet që bëhen nga niveli politik është vështirë të jepet përgjigja në nivelet administrative. Bordi i Drejtorëve të AKP-së e ka zbatuar pikën e dytë të vendimit, sipas legjislacionit në fuqi. Vala e fundit, 38 e shitjes së tokave ishte pezulluar ndërsa vala 39 e cila ende nuk ka ndodhë janë vendosur në shitje pronat të cilat janë deri në 10 hektarë, por ende nuk ka bord të drejtorëve për ta ekzekutuar atë shitje.

Albulena Balaj : U tha se vala 39 është ndërpre për shkak të mungesës së bordit, por jo për shkak të vendimit të Qeverisë, çfarëdo vendim që nxjerr qeveria duhet të respektohet.

Avni Jashari, tha se AKP-ja, nuk konsideron se në këtë proces ka pasur shkelje të drejtave të njeriut. Nëse dikush pretendon se ka pasur shkelje duhet ti drejtohet komisionit ose IAP-it, dhe të ndjekin procedurën ligjore. Ai tha se në valën 35, janë aprovuar dy njësi toke në Atmaxhë, me datën 25 shtator 2017, në Bordin e Drejtorëve.

Lirije Kajtazi, tha se a ka mundur komuna me e ndalu procesin, kur e ka ditur saktë situatën, ndërrimin e sistemeve dhe ndërlikueshmërinë e kësaj pune. A është mangësi e komunave apo është mangësi e ligjit për tu dhënë detyrë komunave për të menaxhuar më mirë këtë situatë kur e dinë gjendjen faktike.

Avni Jashari, tha se AKP-ja, 30 ditë më herët i njofton kryetarët e komunave lidhur me shpalljen dhe nëse komuna ka dokumente pronësore që vërtetojnë procesin nga komuna apo ka ndonjë vendim të Kuvendit Komunal për shpallje të interesit të përgjithshëm apo për iniciimin e procesit të shpronësimit, atëherë AKP-ja tërhiqet nga procesi i shitjes. Në rastin konkret nuk ka pasur asnjë pengesë nga komuna.

Milazim Gashi, tha se krejt ky proces ka shkuar fshehurazi nga AKP-ja. Ai tha se ka me i ndjek të gjitha procedurat për ta kthyer pasurin e 170 viteve në pronësi.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se të gjithë jemi për të ju ndihmuar. U tha se dy herë është shpallur tenderi publik dhe herën e dytë ka pasur 4 oferta. Është e pamundur që banorët mos me marrë vesh çka po bëhet kur është diçka publike nëpër media, besoj se ata që kanë dokumentacion drejtësia do të jetë në favor të tyre.

Frashër Krasniqi: Mendoj që ne duhet me nxjerr një deklaratë me të cilën konkludohet se banorëve të fshatit Atmaxhë u janë shkelë të drejtat e Njeriut nga AKP-ja, më shumë se kaq ne si komision nuk mund të bëjmë.

Teuta Haxhiu: E them se ka pasur shkelje të drejtave të njeriut. Nga AKP-ja të kërkojmë me shkrim dokumentacionin nga marrja e vendimit për hapjen e këtij tenderi e deri në fund të këtij procesi, dhe është mirë me ju drejtua edhe Avokatit të Popullit.

Saranda Bogujevci: Të kërkojmë në një përshkrim dhe të gjithë dokumentacionin e këtij procesi, mandej ta kemi Zyrën Ligjore të Kuvendit dhe Avokatin e Popullit në takim dhe pastaj të dilet me një përfundim, në bazë të të dhënave që kemi.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se jemi për kërkimin e dokumentacionit nga AKP-ja, dhe kompletimin e kësaj lëndë, dhe te bartim tek Avokati i Popullit dhe të kërkojmë një përgjigjeje nëse ka shkelje të drejtave të njeriut apo jo në këtë procedurë.

Duda Balje, kryetare, konstatoi që të kërkohet dokumentacioni se si ka shkuar procedura e privatizimit të këtyre tokave dhe pastaj të shikohet se si të procedohet.

2. Të ndryshme.

Duda Balje, kryetare, tha se e kanë kontaktuar disa persona të skemave sociale dhe nëse mendoni për t'i vizituar 6 qendrat. Të shohim nëse ka raste që shumë persona marrin ndihma sociale që nuk janë për këto ndihma, ndërsa ka persona me aftësi të kufizuara që nuk e gëzojnë këtë ndihmë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje